



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 30, Datë 26 / 01 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.7, datë 15.01.2018, të z.K. V, kundër Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë¹ dhe Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Dhora Leka” Tiranë, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të bindjeve politike*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

Referuar deklarimeve të subjektit ankues, z.K. V ka ushtruar profesion e mësuesit prej 25 vitesh dhe ka qenë në marrëdhënie pune për 14 vite si mësues, në shkollën 9 vjeçare “Dhora Leka”, Tiranë.

Me vendimin nr.13, datë 04.02.2015 të Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë, është zgjidhur kontrata e punës me shkollën 9 vjeçare “Dhora Leka”, Tiranë. Në këtë vendim shkaku i largimit nga puna citohet se është për: “*...Thyerje të rëndë të etikës në punë, nëpërmjet shfrytëzimit të nxënësve të shkollës në funksion të propagandimit të imazhit personal*”.

Me datë 05.02.2015, ankuesi e ka kundërshtuar administrativisht vendimin e largimit të tij nga puna pranë DAR Tiranë.

Me shkresën me nr.333/1 prot., datë 17.02.2015 DAR Tiranë, lidhur me motivacionin e largimit të tij nga puna, bën me dije ankuesin se arsyeja ka qenë: “*... disa bluzave me foton të tinda (z.V) të stampuar në to, të cilat i mbajnë veshur nxënësit e shkollës si dhe në pjesën e brendshme të bluzave dallohet logoja e një partie politike. Nga ana Juaj, në shkelje të plotë të detyrave si mësues i kësaj shkolle, nëpërmjet shfrytëzimit të nxënësve të kësaj shkolle keni propaganduar*”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DAR Tiranë.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

imazhin tuaj personal dhe jo vetëm. Për sa më sipër, zgjidhja e kontratës së punës është jo vetëm e drejtë por dhe e bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar”.

Lidhur me argumentimin e dhënë nga DAR Tiranë për arsyen e zgjidhjes së kontratës së punës me z.K. V, ai parashtron se, bluzat janë shpërndarë prej tij për nxënësit e klasës së pestë (klasë që kishte në kujdestari), gjatë një aktiviteti sportiv të shkollës. Ai citon se: “...Stampimi i fotos time është përshkruar nga qëllimi i mirë për të motivuar nxënësit në arritjen e rezultateve sa më pozitive dhe paraprakisht ishte marrë aprovimi i stafit të shkollës dhe prindërve të nxënësve. Në pamundësi për të blerë bluza të reja, me përpjekjet e mija kam arritur të siguroj bluza të një partie politike që prej vitesh kishte pushuar së ekzistuari, siç ishte Partia Demokratike e Reformuar (shuar si person juridik në vitin 2009). Për korrektesë dhe me shpenzimet e mija personale, kam mbuluar logot e tyre me stampime që fshinin tërësisht së jashtmi identifikimin e kësaj logoje. Pra, pamundësia e materialeve të nevojshme na detyroi të improvizonim këto uniforma për aktivitetin sportiv”.

Po ashtu, ankuesi pretendon se vendimi për largimin e tij nga puna është marrë në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në ligj, pasi largimi i mësuesit nga detyra mund të ndodhë vetëm pasi marrjen e kësaj mase ta ketë propozuar Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes që funksionon pranë institucionit arsimor. Nga ana tjetër, ai pretendon se vendimi është në shkelje flagrante të procedurave dhe të afateve të njoftimit, duke theksuar faktin se atij i është mohuar e drejta procedurale për të mbrojtur pozitën e tij duke argumentuar e prapësuar pretendimet e drejtuesit të shkollës, për një shkelje të para 5(pesë) viteve.

Pretendimet që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, subjekti ankues i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me këtë, me vendimin nr.2548 (nr. 2973 Akti), datë 12.05.2015 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë me nr.2973 Akti, me palë paditëse Kristaq Viso³.

Në përfundim, z.K. V kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj tij nga ana e subjekteve sipërcituar dhe të bëjë rikthimin e tij në punë.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

³ Një kopje të vendimit e ka depozituar vetë ankuesi pranë KMD-së.

- Me shkresën me nr.317 prot., datë 04.02.2015 DAR Tiranë ka nxjerrë Vendimin nr.13, datë 04.02.2015 “Për zgjidhjen e kontratës së punës me z.Viso”.
- Me datë 05.02.2015 ankuesi ka marrë dijëni për shkresën, gjë që e ka deklaruar vetë në ankesën e tij pranë Komisionerit⁴.
- Po ashtu, nga shkresa me nr.333/1 prot., datë 17.02.2015 e DAR Tiranë, rezulton se me datë 05.02.2015, z.K. V ka paraqitur ankesë pranë këtij institucioni, duke kundërshtuar vendimin për zgjidhjen e kontratës së tij të punës.
- Pra, *subjekti ankues ka marrë dijëni për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që më datë 05.02.2015, ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 15.01.2018⁵, pra më vonë se një vit nga marrja dijëni; konkretisht pothuajse 3 (tre) vite.*

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e z.K. V, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...”.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ...“Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁶ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje”.

⁴⁴ Referuar formularit të ankesës.

⁵ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

⁶ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

Duke qenë se ankuesi është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁷, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t'i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike

⁷ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.